

**MARRËVESHJE TRANSFERIMI TË PJESËVE TË KAPITALIT
TË SHOQËRISË “TFP Hol” SH.P.K.**

Në Tirane, sot më 17/03/2025, palët e kësaj Marrëveshjeje ranë dakort si më poshtë:

Shitësi:

- **Z. Ervin Çadri**, shtetas shqiptar, lindur me 24/01/1980, ne Tiranë, mbajtes i dokumentit te identifikimit me nr. personal I00124143F, madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar;

(më poshtë referuar “SHITËSI”)

Blerësi:

- **Shoqeria “S.F. Investments” srl**, person juridik, regjistruar sipas ligjeve te shtetit italian me NUIS 06998940966, me seli ne Altamura (Ba), Viale Martiri del 1799, 106 CAP 70022, Itali, perfaqesuar nga Administratore, Znj. Chiara Sardone, mbajtëse e Dokumentit të Identifikimit me Nr. CA88228JH, madhore e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

(më poshtë referuar “BLERËSI”)

MEQËNËSE:

- A. Shitësi zotëron 100% të Kapitalit të Shoqërisë “TFP Hol” Sh.p.k, një shoqëri ekzistuese sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar në Regjistrin Tregtar Shqiptar me **NIPT M51327033B**, me seli në: Rruga "Samë Frasheri", Pallati Vega, Shkalla 1, Ap. 33, Tirane, 1001 (“Shoqëria”), me një kapital prej 2.000.000,00 (dy milion) Lek, i përbërë nga 1 kuotë.
- B. Blerësi dëshiron të blejë 100 % te Kapitalit të Shoqërisë të zotëruar nga Shitesit në shoqërinë e lartpërmendur “TFP Hol” Sh.p.k siç përcaktohet në këtë marrëveshje.
- C. Në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar dhe nenet e Statutit të Shoqërisë, Ortaku i vetëm i shoqërisë Z. Ervin Çadri ka marrë vendimin përkatës për transferimin tek Blerësi Shoqeria “S.F. Investments” Sh.p.k të kapitalit si më sipër.

PER SA ME SIPER, palët bien dakort si më poshtë:

- 1. Shitësi pranon se ka marrë nga Blerësi në mënyrë të plotë të gjithë çmimin e blerjes të rënë dakord në vlerën nominale të kuotës prej 2.000.000,00 (dy milion) Lek, dhe për këtë arsye transferon ketu 100% të Kapitalit të zotëruar nga Shitësi Z. Ervin Çadri tek Blerësi Shoqeria “S.F. Investments” Sh.p.k.
Shitësi deklaron dhe garanton Blerësin se 100% e kuotave te kapitalit që transferohet këtu është në pronësinë e tij të plotë ligjore dhe të lirë nga barra, hipoteke apo pengje.
- 2. Blerësi pranon pronësinë e 100% të kuotave të kapitalit të shoqërisë, duke njohur gjendjen e Shoqërisë dhe bien dakord me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e lindura nga zotërimi i Kuotave brenda Shoqërisë, sipas përcaktimeve të Statutit të Shoqërisë dhe ligjit shqiptar.

3. Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshje, ortakë të shoqërisë dhe pjesët e kapitalit të zoteruara prej tyre në shoqërinë "TFP Hol" Sh.p.k. do të jenë:

- Shoqeria "S.F. Investments" Sh.p.k - zotëron 100% të kapitalit të shoqërisë.

4. Shitësi dhe Blerësi bien dakord të zbatojnë dhe të paraqesin që në kërkesën e parë të palës tjetër të gjitha dokumentet e nevojshme në mënyrë që të kryejnë të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e transferimit të kuotës objekt të kësaj Marrëveshjeje, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit si dhe në çdo autoritet tjetër sipas përcaktimeve të Ligjit Shqiptar.

Kjo Marrëveshje u hartua në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe dhe në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën italiane me vlerë të barabartë ligjore.


Në rast mosmarrëveshje midis paleve do të merret për bazë versioni shqip.

Marrëveshja bazohet në nenin 705 të Kodit Civil (Shqiptar) dhe në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar.

Marrëveshja u lexua nga palët, u gjend e rregullt, në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe u nënshkrua rregullisht prej tyre.

SHITËSI

Ervin Çadri



BLERËSI

**Shoqeria "S.F. Investments" Srl
Perfaqesuar nga
Administratore**

Chiara Sardone


S.F INVESTMENTS SRL
Piazza A. Moro n. 7
70022 ALTAMURA(BA)
C.F./P.IVA: 06998940966